



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:011283

Datë: 15.11.2023

Numri i dokumentit: 04952799

PPP.nr.11/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.a me seli në Prishtinë, ndaj debitorit të përmbarimit F. B , nga fshati Bardh i Madh, komuna Fushë Kosovë, lidhur me çështjen përmbarimore për pagesën e borxhit në shumën prej 474.60 euro, sipas detyrës zyrtare, jashtë seance, me datë 15.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.1078/18, i datës 22.10.2018, i lejuar nga Përmbaruesi Privat I. I. K nga Prishtina, si dhe të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në këtë procedurë, si të palejueshme.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Përmbaruesi I. I. K nga Prishtina me datë 22.10.2018, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.1078/18, sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.a me seli në Prishtinë, ndaj debitorit F. B nga Fushë Kosova, për pagesën e borxhit në shumë prej 474.60 euro, me kamatë ligjore 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, duke u bazuar në ekstraktin e verifikuar nga librat afarist të kontabiliteti, me numër 56225, të datës 27.09.2018.

Kundër urdhrin të lartcekur të përmbaruesit privat ka paraqitur prapësim djali i debitorit S. B, përmes përfaqësuesit sipas autorizimit B. A, i cili përveç tjerash në prapësim ka theksuar se babai i tij tashmë është i ndjerë dhe se ai ka ndërruar jetë me datë 25.04.2004.

Gjykata, me qëllim të verifikimit të këtij fakti, është bazuar në kopjen e certifikatës së vdekjes me numër V 10558214, të cilën debitori ja ka bashkangjitur prapësimin.

Nga Certifikata me numër serik..., e datës 28.12.2022, gjykata konstatoi se debitori F. B , ka ndërruar jetë më 25.04.2004. Gjykata, pasi që nga provat e përmendura si më lartë vërtetoi se debitori ka vdekur, erdhi në përfundim se urdhri për përmbarrim është i palejueshëm, sepse është lëshuar ndaj një personi i cili nuk mund të paraqitet si palë në procedurë, pasi që në kohën kur është lëshuar urdhri përmbarrimor, pra me datë 22.10.2018, debitori ka qenë i vdekur, sepse siç u vërtetua më lart debitori ka vdekur me datë 25.04.2004.

Gjykata vendosi kështu duke u bazuar në nenin 2, paragrafi 1, pika 1.6 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore (LPP) ku është paraparë se “*Palë - kreditori apo debitori në procedurën përmbarruese*”, ndërsa me nenin 17 të LPP-së parashihet se “*Në procedurën përmbarrimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër*”. Po ashtu neni 73, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka paraparë se “*Palë në procedurë mund të jetë çdo person fizik dhe juridik*”, ndërsa neni 76 i LPK-së parasheh se “*Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm*”.

Nga arsyet e lartcekura, gjykata vendosi që ta anulojë Urdhrin Përmbarrimor P.nr.11/2023, të datës 22.10.2018, si të palejueshëm, pasi që procedura nuk mund të fillohet, zhvillohet dhe përfundojë ndaj një personi i cili është i vdekur.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, vendosi duke u bazuar në nenin 13 të LPP-së, ashtu që vendosi që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta të procedurës. Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATATHEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË

Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.11/23, datë 15.11.2023

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim, gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*